



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. _____ Prot.

Fier, më 22. 11.2022

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit Paraparak për procedurën me objekt “**Rikonstruksioni i argjinaturës për mbrojtjen nga lumi Vjosa, zona Kafaraj-Çerven (Bankina e Degës së Martinës Prog.4668 ml-prog.6000 ml L=1332 ml)**”, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

BASHKIA FIER

Data: 22.11.2022

Drejtuar: Operatorit ekonomik “LLAZO” SHPK

Adresa: RR “Kemishtaj”, Nd. 172, Bishqethem, Kolonje, 9007, Lushnje, Albania

NUIS K24218401K

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur me mjete elektronike**

Numri i referencës së procedurës / lotit: **REF-44847-10-07-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rikonstruksioni i argjinaturës për mbrojtjen nga lumi Vjosa, zona Kafaraj-Çerven (Bankina e Degës së Martinës Prog.4668 ml-prog.6000 ml L=1332 ml**”

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **13 (trembedhjetë) javë** (sipas grafikut të punimeve).

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [17 Tetor 2022], [Numri 143].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

* * *

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë ka marrë pjesë **11 (njëmbëdhjetë)** Ofertues, si mëposhtë me vlerën përkatëse të ofruar:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **AIDA CONSTRUCTION SHPK** me NUIS M03116403L dhe **6D-PLAN SHPK** me NUIS L62717405H. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 29 343 347.6 (*njëzet e nëntë milion e treqind e dyzetë e tremijë e treqind e dyzetë e shtatë pike gjashtë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **DENIS-05 SHPK** me NUIS K51518029B dhe **XHAST SHPK** me NUIS K12512837I. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 26 906 482.13 (*njëzet e gjashtë milion e nëntëqind e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy pikë trembëdhjetë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **2Z KONSTRUKSION SHPK** me NUIS J63229466K, **FLED SHPK** me NUIS K17621104C dhe **GRAND KONSTRUKSION M SHPK** me NUIS L38109801T. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 27 000 007(*njëzet e shtatë milion e shtatë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **NGRACAN 1934 SHPK** me NUIS J87602809S, **GLAVENICA SHPK** me NUIS K17710805A dhe **Shpresa-AL SHPK** me NUIS K31321021N. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 28 029 254.5 (*njëzet e tetë milion e njëzet e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër pikë pesë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
5. Operatori Ekonomik **Shendelli SHPK** me NUIS K07924803N. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 29 865 563 (*njëzet e nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
6. Operatori Ekonomik **SARK SHPK** me NUIS K52531415H. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 29 335 423(*njëzet e nëntë milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzet e tre*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
7. Operatori Ekonomik **MODESTE SHPK** me NUIS J62903413B. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 26 244 501.13 (*njëzet e gjashtë milion e dyqind e dyzetë e katër mijë e pesëqind e një pikë trembëdhjetë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
8. Operatori Ekonomik **LLAZO SHPK** me NUIS K24218401K. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 22 936 907 (*njëzet e dy milion e nëntë qind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

9. Operatori Ekonomik **L.T.E CONSTRUCTION SHPK** me NUIS L78006801F. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 24 734 305 (*njëzet e katërmilion e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e pesë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
10. Operatori Ekonomik **DESARET COMPANY SHPK** me NUIS K01816001J. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 31 720 071.42 (*tridhjetë një milion e shtatëqind e njëzet mijë e shtatëdhjetë e një pikë dyzetë e dy*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
11. Operatori Ekonomik **BEQIRI SHPK** me NUIS J98624801V. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 23 253 790 (*njëzet e tre milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

❖ **Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Bashkimi I Operatorëve Ekonomik AIDA CONSTRUCTION SHPK me NUIS M03116403L dhe 6D – PLAN SHPK me NUIS L62717405H

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik AIDA CONSTRUCTION SHPK, me NUIS M03116403L dhe 6D – PLAN SHPK, me NUIS L62717405H, KVO konstatoi se:

- Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është plotësuar pika 2.3.1 ”Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:
 - a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet(pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

ose

- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).”*

Për arsye se:

Operatori ekonomik AIDA SHPK dhe 6D-Plan SHPK, të cilët sipas marveshjes së bashkëpunimit datë 20.10.2022, kanë përcaktuar se 78% e punimeve do të kryhen nga AIDA SHPK dhe 22% e punimeve do të kryhen nga 6D-Plan SHPK, bazuar në nenin 88, pika 3, paragrafi i dytë i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin citohet:

“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”

Operatori ekonomik AIDA SHPK dhe 6D-Plan SHPK duhet të plotësojnë kriterin 2.3.1.

- Kontrata e ndërtimit nr. 4561 rep., nr. 1993 kol., datë 02.12.2021, me objekt “Magazinë për grumbullimin e produkteve Bujqësore”, lidhur midis Shoqerisë AM FRUITS dhe AIDA SHPK, paraqitur në SPE, nuk është punë e ngjashme duke mos plotësuar kriterin 2.3.1/a të shtojcës 7 të DST-së.
- Kontratat e paraqitura në SPE, nga operatori 6D-Plan SHPK, nuk e plotësojnë kriterin 2.3.1. Konkretisht:

Operatori ekonomik 6D-Plan SHPK ka paraqitur në SPE këto kontrata:

- “Rikonstruksion i Zyrave të Qendrës së Grumbullimit të Trajtimit të Kimikateve”, lidhur midis Qendrës së Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve dhe 6D-Plan SHPK, nuk është punë e ngjashme.
- “Rehabilitimi i rrjetit të ujitjes me kanal V-4 gjatësia 465 ml dhe sekondar 400 ml të fshatit Belinë, Zharrëz”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe 6D-Plan, i mungon Akti i Vlerësimit, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikes 2.3.1, nëndarja (i).
- “Sinjalistikë horizontale”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe 6D-Plan SHPK, nuk është punë e ngjashme.
- Shërbimi i lyerjes së godinës së Drejtorisë së Arkivit Qëndrore të ISSH-së“, Luvër, Tiranë”, lidhur midis Drejtorisë së Arkivit Qëndror të ISSH-së dhe 6D-Plan SHPK, nuk është punë e ngjashme, si dhe i mungon Situacioni Përfundimtar, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikes 2.3.1, nëndarja (i).
- Ndërrhyrje për riparimin dhe përshtatjen e ambjenteve të godinës së Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe dhe Inxhinierisë Fizike, për shfrytëzim nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit deri në përfundimin e punimeve për rehabilitimin strukturor të godinës së vjetër të FIN të dëmtuara nga lëkundjet sizmike të datës 26 nëntor”, lidhur midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe 6D-Plan, nuk është punë e ngjashme.
- Kontrata nr. 3402/1 prot, datë 19.02.202, lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Vlorë dhe 6D-Plan është në gjuhë të huaj.
- “Hidroizolimi i çatisë dhe sistemimi i murit rrethues dhe sistemimi i territorit të kopshtit nr.11 Bashkia Elbasan”, lidhur midis Këshillit të Qarkut Elbasan dhe 6D-Plan, nuk është punë e ngjashme.

Ndërsa, kontrata:

- “Ndërtimi i murit rrethues të Uzinës së Plehrave Azotik Fier”, me vlerë 5 979 159 lekë pa tvsh;
- “Rikonstruksion Ujësjiellësi Suhe dhe Libohovë”, me vlerë 958 792 lekë pa tvsh;
- “Rikonstruksion rrugësh dhe ndërtim muresh në lagjen Spaval Dars, Bejn dhe Mishter”, me vlerë 3 853 070 pa tvsh

nuk plotësojnë vlerën e kërkuar sipas pikes 3.2.1 të shtojcës 7 të DST-së.

- Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, nuk është plotësuar pika 2.2.1:
”Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (2020, 2021), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është ne

kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel."

- Operatori ekonomik 6D-Plan ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", i ligjit nr.10091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, dhe nuk ka paraqitur akt ekspertizën e ekspertit kontabel për bilancin e vitit 2020 dhe 2021.
- Referur Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti Teknik", nuk është plotësuar gërma "b" e pikës 2.3.5 "Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion":
"Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesiose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):
 - Kokore, minimum 17 copë.
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 2 copë.
 - Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4 copë.
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë."
- Nga ana e BOE AIDA SHPK & 6D-Plan SHPK nuk është deklaruar asnjë informacion në lidhje me:
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 2 copë.
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.

2. Operatori ekonomik BEQIRI SHPK, me NUIS J98624801V

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik BEQIRI SHPK, me NUIS J98624801V, KVO konstatoi se:

- Referur Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3 "Kapaciteti Teknik", nuk është plotësuar gërma "b" e pikës 2.3.5 "Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion":
"Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit):
 - Kokore, minimum 17 copë.
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi, 2 copë.
 - Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 4 copë.
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë."

- Nga ana e operatorit ekonomik BEQIRI SHPK, në Formularin e Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8 të DST-së, nuk është deklaruar asnjë informacion, as nuk është listuar asnjë nga pajisjet e kërkuara si më sipër cituar.

3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomike DENIS-05 SHPK me NIUS K51518029B dhe XHAŠT SHPK me NIUS K12512837I,

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve DENIS-05 SHPK me NIUS K51518029B dhe XHAŠT SHPK me NIUS K12512837I, KVO konstatoi se:

- Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është plotësuar pika 2.3.1 *”Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:*
 - a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

ose

- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).”*

Për arsye se:

Operatori ekonomik DENIS-05 SHPK dhe XHAŠT SHPK, të cilët sipas kontratës së bashkëpunimit datë 25.10.2022, kanë përcaktuar se 73.89 % e punimeve do të kryhen nga DENIS-05 SHPK dhe 26.11 % e punimeve do të kryhen nga XHAŠT SHPK, bazuar në nenin 88, pika 3, paragrafi i dytë i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin citohet:

“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”

Operatori ekonomik DENIS-05 SHPK dhe XHAŠT SHPK duhet të plotësojnë kriterin 2.3.1.

- Kontrata e ndërtimit nr. 4561 rep., nr. 1993 kol., datë 02.12.2021, me objekt “Mirëmbajtje me performancë Tiranë-Dajt-Qafë Mollë-Bizë-Qafë Priskë-Shkallë-Shën Gjergj, Uzina e Traktorit, Lanabregas, Sauk-Farkë”, lidhur midis Drejtorisë së Rajonit Qëndror, Tiranë dhe XHAŠT SHPK & ALB SHPRESA SHPK & MELA SHPK, paraqitur në SPE, i mungon Akti i Kolaudimit, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikës 2.3.1, nëndarja (i).
- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se bashkimi i operatorëve është mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera në lidhje me plotësimin e numrit të nevojshëm për specialistë të çertifikuar

sipas profesioneve të kërkuara në dokumentat e tenderit, për të cilët nuk është paraqitur formular vetëdeklarimi sipas shtojcës 7 nga subjektet mbështetëse, në të cilën parashikohet:

“ Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomike 2Z KONSTRUKSION SHPK me NUIS J63229466K, FLED SHPK me NUIS K17621104C dhe GRAND KONSTRUKSION M SHPK me NUIS L38109801T

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomik 2Z KONSTRUKSION SHPK me NUIS J63229466K, FLED SHPK me NUIS K17621104C dhe GRAND KONSTRUKSION M SHPK me NUIS L38109801T, KVO konstatoi se është mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera në lidhje me plotësimin e numrit të nevojshëm për specialistë të çertifikuar sipas profesioneve të kërkuara në dokumentat e tenderit, për të cilët nuk është paraqitur formular vetëdeklarimi sipas shtojcës 7 nga subjektet mbështetëse në të cilën parashikohet:

“ Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

5. Operatori ekonomik L.T.E CONSTRUCTION SHPK, me NUIS L78006801F

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik L.T.E CONSTRUCTION SHPK, me NUIS L78006801F, KVO konstatoi se:

Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti Teknik”, nuk është plotësuar gërma “c” e pikës 2.3.2 “Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar per keto punime” :

“Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë pune të vlefshme për periudhen e realizimit të kontratës specialistë të çertifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë:

- Automakinist 5 (pesë)
- Eskavatorist 5 (pesë)
- Buldozerist 3 (tre)
- Operatori ekonomik L.T.E CONSTRUCTION SHPK, referuar Formularit të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, ka deklaruar 1(një) automakinist dhe 4(katër) eskavatorist.

Sa më sipër, nuk plotësonë numrin e nevojshëm të specialistëve të çertifikuar sipas profesioneve si më sipër.

6. Operatori ekonomik SARK SHPK me NUIS K52531415H

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik SARK SHPK, me NUIS K52531415H, KVO konstatoi se:

- Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, nuk është plotësuar pika 2.3.1 ”Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:
- a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

ose

- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).”*

Kontratat e paraqitura në SPE, nga operatori ekonomik SARK SHPK, nuk e plotësonë kriterin 2.3.1. Konkretisht:

- “Rikonstruksion rruga Lalëzit dhe rikonstruksion rruga Gjuricaj”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës dhe SARK SHPK, i mungon Akti i Vleresimit, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikes 2.3.1, nëndarja (i).
- “Sistemim asfaltim rruga e Gështenjave Rrencë, Guri i Zi”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe SARK SHPK, i mungon Akti i Vleresimit, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikes 2.3.1, nëndarja (i).
- “Mbrotjtje nga Përoi i Kushës të tokës bujqësore fshati Karakullak, Njësia Administrative Bradashesh, Elbasan”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe SARK SHPK, i mungon Akti i Vleresimit, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikes 2.3.1, nëndarja (i).
- “Sistemim asfaltim i rrugës së Rrahit, pranë objektit të kultit Arramerras Fushë-Krujë”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë dhe SARK SHPK, i mungon Akti i Vleresimit, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikes 2.3.1, nëndarja (i).
- “Sistemim asfaltim i rrugës nga rruga e tregut Pallati i Kulturës Krujë”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Krujë dhe SARK SHPK, i mungon Akti i Vleresimit, një nga dokumentat e kërkuar referuar pikes 2.3.1, nëndarja (i).

Ndërsa, kontrata:

- “Sistemim i Përoit të Balldremit, fshti Balldrem dhe fshati Vidhas, Njësia Administrative Papër”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe SARK SHPK, me vlerë 1 197 720 lekë pa tvsh.
- “Sistemim i Përoit të Papër të tokës bujqësore, fshti Pajun, Njësia Administrative Papër”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe SARK SHPK, me vlerë 1 759 810 lekë pa tvsh.
- “Mbrotjtje nga Përoi i Muçanit të tokës bujqësore, fshti Muçan, Njësia Administrative Tregan, Elbasan”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe SARK SHPK, me vlerë 759 920 lekë pa tvsh.
- “Mbrotjtje nga përoi i Llixhës, fshati Gjormë, dhe mbrotjtje nga Zalli i Gostimës të tokës bujqësore fshati Bujaras, Njësia Administrative Gjergjan, Elbasan”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe SARK SHPK, me vlerë 1 564 450 lekë pa tvsh.

- “Shpenzimet për riparimet me asfaltobeton”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe SARK SHPK, me vlerë 1 296 721,67 lekë pa tvsh.
- “Pastrim dhe sistemim i shtratit të përenjëve në Xibrakë(Grabozë+Bahiti)dhe përenjëve Griqan, fshatrat Xibrakë dhe griqan, Njësia Administrative Labinot-Fushë”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe SARK SHPK, me vlerë 1 618 457.5 lekë pa tvsh.
- “Mbrotjtje nga përroi Allambres fshati Mbërs, L360”, lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe SARK SHPK, me vlerë 1 282 370 lekë pa tvsh.

nuk plotësojnë vlerën e kërkuar sipas pikes 3.2.1 të shtojcës 7 të DST-së.

- Referuar Shtojcës 7 të DST-së, pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, nuk është plotësuar pika 2.2.1, në të cilin kërkohet:

”Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (2020, 2021), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet te shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.”

- Operatori ekonomik SARK SHPK ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, i ligjit nr.10091, datë 5.3.2009, *”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”*, i ndryshuar, dhe nuk ka paraqitur akt ekspertizën e ekspertit kontabël për bilancin e vitit 2020.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“LLAZO” SHPK** me **NUIS K24218401K** dhe adrese, **Rr. “Kemishtaj”, Nd. 172, Bishqethem, Kolonje, 9007, Lushnje, Albania**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **22 936 907** (njëzet e dy milion e nëntë qind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatë) **lekë pa TVSH** dhe **27 524 288.4** (njëzet e shtatë milion e pesëqind e njëzet e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë pikë katër) **lekë me TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ZYRTARI I AUTORIZUAR

Zv.Kryetari

Andius OLLDASHI